



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr.719/6prot.

Tepelenë, më,01.04.2022

**VENDIM**

**Nr.22. datë 31. 03. 2022.**

**PËR**

**ZHVILLIMIN E PRONËS NR. 1/7, ZONA KADASTRALE NR. 3177, ME ZHVILLUES subjektin "AGROTURIZEM REXHINI" SHPK me NIPT M19820502R; SI DHE AUTORIZIMIN E ZHVILLUESIT APO PËRFAQËSUESIT ME PROKURË NOTERIALE, TË APLIKOJË PËR PAJISJEN E OBJEKTIT/INVESTIMIT ME LEJET PËRKATËSE, NË PORTALIN "E-ALBANIA"**

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar; Kontratën nr. 1906, nr. 784 kol., datë 10.12.2021; Miratimin e kontratës së nën qirasë; Kontratën nr. 1974 rep., nr. 813 kol., datë 21.12.2021; Relacionit nr. AR-R03012 datë 02.02.2022 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë Tepelenë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

**V E N D O S I:**

1. Zhvillimin e pronës nr. 1/7, zona kadastrale nr. 3177, me zhvillues subjektin "AGROTURIZEM REXHINI" SHPK me NIPT M19820502R; si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit me prokurë noteriale, të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse, në portalin "e-Abania".

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrër.

**KRYETAR**

**ELVIS SHEHU**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Valbona ÇELA**

Miratur me 12 vota

Vota Pro 12

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë ,01.04.2022.

